

VENDIM
Nr. 839, datë 5.12.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË PROCEDURAVE PËR
RIMBURSIMIN E AKCIZËS SË PAGUAR DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE
LEHTËSUESE, PËR NDËRTIMIN E BURIMEVE TË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, ME FUQI TË INSTALUAR JO MË PAK SE 5MW**
(Ndryshuar me VKM nr. 20, datë 11.1.2012)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar dhe të nenit 5 të ligjit nr. 8987, datë 24.12.2002 “Për krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personi juridik, vendas ose i huaj, i cili ndërton burime të prodhimit të energjisë elektrike, me fuqi të instaluar jo më pak se 5MW për burim, që përdorin lëndë djegëse të lëngëta ose të ngurta dhe pa kufizim për burime të tjera të rinovueshme të prodhimit, pasi të ketë marrë nga organet shtetërore përkatëse lejen për ndërtimin e një objekti gjenerues, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duhet të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për sektorin e energjisë, 6 muaj para fillimit të importimit, listën e plotë e të specifikuar të makinerive dhe të pajisjeve, që do të importohen vetëm për këtë objekt.

Ministri përgjegjës për sektorin e energjisë e miraton këtë listë, pas shqyrtimit dhe verifikimit të saj.

2. Lista e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, duhet të përmbajë, për çdo makineri dhe pajisje, që importohet, këto specifikime:

- a) emërtimin dhe shenjat e njësisë së makinerisë/pajisjes;
- b) karakteristikat kryesore teknike të makinerisë/pajisjes, sasinë dhe çmimin e blerjes;
- c) karakteristikat e lëndëve djegëse, që përdoren, duke specifikuar llojin dhe konsumin e shprehur për njësi;
- ç) specifikime të tjera sqaruese (konsumi specifik i burimit etj.).

3. Lista e miratuar nga ministri përgjegjës për energjinë mbahet në pesë kopje, nga të cilat një kopje i dërgohet subjektit investitor të licencuar, një kopje Ministrisë së Financave, një kopje Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, një kopje Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe një kopje ruhet në ministrinë përgjegjëse për sektorin e energjisë.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pas paraqitjes së kërkesës nga subjekti investitor, zbaton të gjitha procedurat e parashikuara nga legjislacioni doganor për përjashtimin e makinerive dhe të pajisjeve, të përfshira në listën e miratuar nga ministri përgjegjës për energjinë, nga taksat doganore.

5. Institucionet e përmendura në pikën 3, për çdo ndryshim në listën e specifikuar të makinerive dhe të pajisjeve që importohen, veprojnë në përputhje me dokumentet zyrtare, që kërkojnë ndryshimin, dhe për këtë japin miratimin përkatës. Në rast se në listën e miratuar më parë është përfshirë një makineri/pajisje, që nuk i takon këtij objekti, veprimet doganore kryhen vetëm pasi të shlyhet dhe të dokumentohet pagesa e taksës doganore, që nuk i ishte paguar, në zbatim të këtij vendimi.

6. Për lëndët djegëse të përdorura nga subjektet, të cilat ndërtojnë burime të prodhimit të energjisë elektrike, me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW për burim, për nevojat e veta apo

për shitje, vlera e akcizës që do të rimbursohet, llogaritet sipas formulës së paraqitur në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Personi juridik, vendas ose i huaj, i cili ndërton burime të prodhimit të energjisë elektrike me fuqi të instaluar jo më pak se 5MW për burim, që përdorin lëndë djegëse të lëngëta ose të ngurta, dhe pa kufizim për burime të tjera të rinovueshme të prodhimit, për rimbursimin e akcizës së këtyre lëndëve, duhet të paraqesë *brenda datës 10 të muajit pasardhës, në drejtorinë rajonale ku është i regjistruar.*

a) Aplikimin për sasinë e lëndës djegëse, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit, e cila nevojitet për prodhimin e energjisë elektrike *për një periudhë njëmuajore*, përfshirë dhe shumën e akcizës, që do të rimbursohet.

b) Akcizën e paguar për lëndët djegëse, të lëngëta ose të ngurta, të importuara nga subjekte të tjera ose vetë subjekti prodhues i burimeve të energjisë elektrike (vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për pagesën e akcizës).

8. Energjia elektrike, e prodhuar nga burimet, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi, matet nëpërmjet matësit të energjisë elektrike për rastin e shitjes dhe nga matësi i gjeneratorit elektrik, kur ajo prodhohet, kryesisht, për nevojat e veta.

9. Sasia e energjisë elektrike, të shitur apo të prodhuar, vlerësohet çdo muaj si diferencë e leximeve të matësit në fillim dhe në fund të muajt.

Sasia e energjisë elektrike, që u shitet të tretëve, matet në kwh/muaj dhe deklarohet në faturën e përbashkët të mbajtur, ndërmjet shitësit dhe blerësit, ndërsa sasia e energjisë së prodhuar deklarohet nga prodhuesi, sipas vlerës së treguar në matësin e vendosur në dalje të gjeneratorit elektrik.

10. Dega e tatimeve e rrethit përkatës, në bashkëpunim me strukturat e subjekteve shpërndarëse të energjisë elektrike, bëjnë plumbosjen e matësve të energjisë elektrike, duke mbajtur procesverbal. Dega e tatimeve kontrollon, çdo muaj, sasinë e energjisë së prodhuar për shitje dhe për nevojat e veta. Subjekti prodhues i energjisë elektrike deklaron, çdo muaj, në degën e tatimeve energjinë e prodhuar kryesisht për nevojat e veta, në bazë të leximeve të matësit të gjeneratorëve elektrikë.

11. Me konsum specifik të lëndës djegëse në burim nënkuptohet sasia e lëndës djegëse të përdorur për prodhimin e 1 KWH energji elektrike. Në këtë vlerë përfshihet edhe sasia e lëndës djegëse, që konsumohet për nevojat e centralit elektrik.

12. *Rimbursimi i akcizës për lëndën djegëse të konsumuar, të llogaritur sipas formulës, bëhet në mënyrë automatike nga drejtoria rajonale e tatimeve ku është i regjistruar subjekti, nga llogaria e veçantë buxhetore, e krijuar nga kjo drejtori për këtë qëllim.*

12.1. *Brenda datës 10 të muajit pasardhës, subjekti paraqet kërkesën për rimbursim. Me paraqitjen e kërkesës për rimbursim nga subjekti, drejtoria rajonale tatimore, ku subjekti është i regjistruar, është e detyruar të kryejë rimbursimin automatik të shumës së kërkuar në rast se subjekti, që ka paraqitur kërkesën për rimbursim, plotëson kushtet e mëposhtme:*

a) *Nuk bën kërkesë për rimbursim për herë të parë:*

b) *Është audituar në 3 (tri) vitet e fundit;*

c) *Nuk ka asnjë detyrim tatimor ose kontribute të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore apo penalitete të papaguara;*

ç) *Ka deklarim të rregullt të TVSH-së dhe s'ka penalizime.*

12.2. *Kërkesa e paraqitur nga subjekti, që plotëson kriteret e sipërpërmendura për rimbursimin automatik, vlerësohet dhe për të procedohet, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga inspektorët e drejtorisë rajonale tatimore. Kërkuesit për rimbursim mund të kontaktohen për të sqaruar problemet, por atyre nuk do t'u kërkohen dokumente shtesë, përveç dokumenteve të përcaktuara në këtë pikë. Kërkesat, që nuk plotësojnë kushtet, do të dërgohen për kontroll dhe, në këtë rast, kërkuesit mund t'i kërkohet të paraqesë dokumente shtesë.*

12.3. *Në rast se kërkesa për rimbursim paraqitet nga një person i tatueshëm për herë të*

parë, organi tatimor duhet të verifikojë në vend saktësinë e shumës së rimbursimit të kërkuar dhe e miraton atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Kontrolli i kërkesave për rimbursim bëhet duke respektuar radhën kohore të paraqitjes së kërkesave. Rimbursimi kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike pas miratimit të shumës për t'u rimbursuar.

12.4. Në rast se drejtoria rajonale tatimore, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nuk procedon me rimbursimin automatik, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, në masën e akcizës së pretenduar për rimbursim.

12.5. Kontrolli i kërkesave për rimbursim bëhet duke respektuar radhën kohore të paraqitjes së kërkesave.

12.6. Në rast se gjatë kontrollit rezulton se ka pasur pasaktësi ose pavërtetësi të dokumenteve, subjekti përfitues i rimbursimit duhet të kthejë të gjithë shumën e rimbursuar, si dhe mbi të zbatohen penalitetet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore.

13. Rimbursimi i kundërvleftës së taksës doganore, të llogaritur sipas formulës përkatëse në shtojcën 1, bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e llogaritur nga llogaria e veçantë buxhetore e krijuar nga kjo drejtori për këtë qëllim dhe jo më vonë se 5 ditë nga data e kryerjes së veprimeve në doganë.

14. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri përgjegjës për energjinë të nxjerrin udhëzimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

15. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri përgjegjës për energjinë për zbatimin e këtij vendimi.

16. Vendimi nr. 560, datë 27.8.2004 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e disa kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Shtojca 1: Formula e llogaritjes së vlerës që do të rimbursohet

1. Kur akciza shprehet me kuotë fikse

$$VrA = Psh/p * Nt * A$$

2. Kur akciza shprehet në përqindje

$$VrA\% = Psh/p * Nt * (Vld * A\%)$$

3. Kur taksa doganore shprehet në përqindje

$$VrD = (Psh * Nt * Td) / \text{Sasinë totale (sipas DAV-it përkatës)}$$

ku:

VrA - Vlera e rimbursimit të akcizës së lëndës djegëse për energjinë elektrike të shitur apo prodhuar, kur akciza është e shprehur në kuotë fikse, (lekë/muaj).

VrA% - Vlera e rimbursimit të akcizës së lëndës djegëse për energjinë elektrike të shitur apo prodhuar, kur akciza është e shprehur në përqindje, (lekë/muaj).

Psh/p - Energjia elektrike e shitur apo prodhuar, sipas këtij vendimi.

Nt - Konsumi specifik i lëndës djegëse për prodhimin e energjisë elektrike (kg/kWh për lëndët djegëse të lëngëta e të ngurta; m³ N/kWh për lëndët djegëse të gazta).

A - Akciza kur shprehet me kuotë fikse, sipas llojit të lëndës djegëse dhe e përcaktuar në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (lekë/kg).

A% - Akciza kur shprehet në përqindje, sipas llojit të lëndës djegëse dhe e përcaktuar në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”.

Vld - Vlera doganore e mallit, lëndës djegëse, siç përcaktohet në Kodin Doganor dhe të shënuar në deklaratën doganore përkatëse.

VrD - Vlera e rimbursimit të kundërvlehtës doganore të paguar për sasinë e lëndës djegëse për energjinë elektrike të shitur (lekë/muaj).

Psh - Energjia elektrike e shitur sipas këtij vendimi.

Td - Taksa doganore sipas DAV-it përkatës.

Normatika elektrike (Nt= Konsumi specifik) për teknologji dhe lëndë djegëse të ndryshme, që si rregull i jepen në dokumentacionin teknik, për çdo rast konkret llogaritet duke përdorur formulën:

$$Nt = 360\,000 / (\eta * Q)$$

Ku:

η - rendimenti i përdorimit teknik të impiantit gjenerues (sipas katalogut) (%).

Q- nxehtësia e djegies (fuqia kalorifike) e lëndës djegëse (kJ/Nm³; kJ/kg).

Tabela e mëposhtme është zbatimi praktik i formulës dhe mund të merret si referim për disa nga lëndët djegëse më të përdorshme.

Tabela 1: Vlerat e pranura si normativa teknike (Nt) për konsum specifik të lëndëve djegëse kryesore, që përdoren në objektet e gjenerimit të energjisë elektrike

LËNDA DJEGËSE/TIPI MARKA	NXEHTËSIA E DJEGIES Q	MOTOR DIEZEL (DM)	TURBINË GAZI (GT)	TURBINË AVULLI (ST)	CIKËL I KOMBINUAR (CCGT)
GAZ NATYROR	40186	0.215 M ³	0.307	0.246	0.165 M ³

NATYRAL GAS	KJ/M ³ N	N.KWH	M ³ N/KWH	M ³ N/KWH	N/KWH
GAS OIL	41860	0.205	0.307	0.253	0.179
DISTILAT OIL	KJ/KG	KG/KWH	KG/KWH	KG/KWH	KG/KWH
SOLAR	41000	0.214	0.325	0.266	0.187
FUEL OIL	KJ/KG	KG/KWH	KG/KWH	KG/KWH	KG/KWH
MAZUT	40000	0.225	NUK	0.273	NUK
HEAVYFUEL OIL	KJ/KG	KG/KWH	REKOMANDOHE T	KG/KWH	REKOMANDO HET TË PËRDORET
QYMYR GURI	29300	NUK	NUK PËRDORET	0.384	NUK
HARD COAL	KJ/KG	PËRDORET DIREKT	DIREKT	KG/KWH	PËRDORET DIREKT
QYMYR LINJIT	15070	NUK	NUK PËRDORET	0.771	NUK
LIGNITE COAL	KJ/KG	PËRDORET DIREKT	DIREKT	KG/KWH	PËRDORET DIREKT